



## Sulmet ndaj të Drejtave të Grave Duhet të Ndalen

*Deklaratë Kolektive Feministe*

Një model shumë shqetësues po shfaqet me koherencë të qëndrueshme në debatet e vazhdueshme që po mbahen në disa agjenci shumëpalëshe – një sulm sistemik i ripërtërirë ndaj grave. Instrumentalisht festohen si kujdestare familjare vetësakrifikuese, profesioniste të përkushtuara të kujdesit shëndetësor, ose nëna ushqyese të thirrura për të përmbushur funksionin e tyre riprodhues, gratë e gjejnë veten gjithnjë e më shumë të mbyllura dhe të shtypura brenda narrativave të rreme dhe të vjetra të stereotipeve shëndetësore që përforcojnë rolet e tyre të caktuara si persona të cenusëshëm. Por realiteti i grave është ndryshe: ato janë, në fakt, bërë të cenusëshme. Deklaratat formale që marrin janë në kundërshtim të thellë me masat e kursimit që reduktojnë angazhimet dhe detyrimet financiare publike për funksionet e tyre thelbësore dhe punët e tjera të riprodhimit shoqëror, duke përkeqësuar më tej shfrytëzimin e grave dhe vajzave që vazhdojnë të kryejnë masivisht punë të papaguar <sup>[1]</sup>. Kjo pabarazi jo vetëm që minon vetëvendosjen dhe pjesëmarrjen socio-politike të grave. Ajo gjithashtu ekspozon trashëgiminë e qëndrueshme të një padrejtësie strukturore më të thellë që kërkon vëmendjen, analizën dhe veprimin tonë të menjëhershëm dhe të përditshëm.

Pas pandemisë dhe viteve të luftërave të rinovuara globale, e drejta e grave për të shprehur agjencinë politike mbi trupat e tyre është sërish nën sulm brutal, në disa mënyra. Sulmet aktuale mbi të drejtat dhe mirëqenien e grave po ndodhin – dhe po lulëzojnë – globalisht. Në Afganistan gratë janë përjashtuar pa mëshirë nga sfera publike, ndërsa në Iran guximi i grave ka rezultuar në represione brutale të ndjekura nga patriarkati fetar. Ndërkohë, në SHBA, reformat ligjore po çrrënjosin të drejtën për abort, dhe po kufizojnë qasjen në kujdesin seksual dhe riprodhues më gjerësisht <sup>[2]</sup>. Në Evropë, një direktivë në diskutim rrezikon të dekriminalizojë përdhunimin dhe të zbrazë Konventën e Stambollit. Në Gaza dhe Bregun Perëndimor, institucionet e Kombeve të Bashkuara dhe Shtetet Anëtare ende mbeten të paralizuar në prag të një konflikti që deri më tani ka vrarë mbi 35,000 njerëz (që nga 12 maji) <sup>[3]</sup> – me gratë dhe fëmijët që përfaqësojnë shumicën e viktimave. E njëjta histori, i njëjti fat, si në të gjitha konfliktet e armatosura.

Lufta është në fakt thelbi i sistemit patriarkal. Agresioni justifikon shtypjen dhe abuzimi bëhet mjeti i preferuar për "zgjidhjen" e konfliktit <sup>[4]</sup>. Këto dinamika obsesive e bëjnë trupin e grave fushëbetëjën perfekte të luftës strukturore.

Edhe në Organizatën Botërore të Shëndetësisë – ku zyrtarët u gjetën fajtorë për sulme seksuale kundër grave dhe vajzave në Republikën Demokratike të Kongos gjatë Covid-19 dhe mbijetueset u paguan 250 dollarë secila <sup>[5]</sup> – thirrjet e fundit për reforma të ndjeshme ndaj gjinisë dhe mbrojtjen e të drejtave të grave po kundërshtohen sërish <sup>[6]</sup>. Pavarësisht ekzistencës së instrumenteve të shumta normative ndërkombëtare dhe mekanizmave

rajonale që njohin dhe afirmojnë të dyja <sup>[7]</sup>, të drejtat themelore seksuale dhe riprodhuese vazhdojnë të përballen me sfida të hapura.

Si po justifikohet kjo? Brenda OBSH-së, disa argumentojnë se të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues janë çështje "politike" që duhet të trajtohen nga qeveritë kombëtare, pasi ato shkojnë përtej mandatit "teknik" të OBSH-së. Por shëndeti është në mënyrë të pandashme politik – një realitet që Kushtetuta e OBSH-së e pranon në mënyrë eksplicite kur pohon se faktorët strukturore politikë, të tillë si zhvillimi i pabarabartë dhe diskriminimi, janë pengesa për arritjen e së drejtës për shëndet. Kushtetuta e OBSH-së gjithashtu njihet paqen, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përgjegjësinë e qeverive për mirëqenien e popujve të tyre si thelbësore për shëndetin. Kjo bashkësi ngre një pyetje themelore: si ka mundësi që rëndësia politike e OBSH-së shkakton shqetësim kur flasim për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave, ndërkohë që i njëjti nivel shqetësimi nuk vërehet në çështje të tjera të ndjeshme politike? Inkurajimi i vendeve për të mbajtur shpenzimet shëndetësore brenda "envelopës fiskale" të tyre ose këmbëngulja në shenjtërinë e të drejtave të pronës intelektuale, edhe nëse këto politika pengojnë qasjen në barna dhe farëra thelbësore, nuk ngjallin të njëjtat reagime të shqetësuara.

Margjinalizimi dhe nënshtrimi sistematik i grupeve shoqërore është një shenjë e fuqisë tërësisht të papranueshme që vazhdon të imponohet. Për gratë dhe komunitetet e tjera të marginalizuara që përballen me të gjitha llojet e padrejtësive, kjo fuqi e ngulitur është e njohur gjerësisht dhe thellësisht – dhe zakonisht referohet si patriarkat. Modelet patriarkale, të ngulitura thellë në fe dhe në trashëgiminë e strukturave institucionale, janë të lehta për t'u përdorur dhe të përdorura gjerësisht, deri në pikën që të pranohen dhe të brendësohen përmes shfaqjeve historike dhe të përjetshme të kolonializmit, imperializmit dhe populizmit. Qendrore për të gjitha këto manifestime është shtypja e zërave, agjencisë dhe autonomisë trupore.

Si trajtohen gratë dhe pakicat e tjera sot në sistemin shumëpalësh vetëm reflekton logjikën e pafundme patriarkale. Kjo është e maskuar me retorikë të pabindshme të shoqëruar me ndërhyrje minimale që kanë për qëllim të ngrenë bazën në rastin më të mirë. Shumë shpesh, megjithatë, iniciativa të tilla përfundojnë duke rikonfirmuar status quo-në e roleve shoqërore të stereotipuara. Ato nuk trajtojnë rrënjët e dhunës direkte të trashëguara në një sistem ku Shtetet Anëtare gjoja flasin për gratë e tyre – sikur gratë të ishin prona!

Në botë, gratë përfaqësojnë shumicën. Institucionet politike në çdo nivel kanë një detyrim ligjor për të njohur dhe nderuar këtë realitet, në vend që ta minojnë atë pjesë-pjesë. Është imperative për të gjitha gratë të bashkohen dhe të forcojnë luftërat e tyre të përbashkëta për të nxitur qeveritë dhe institucionet shumëpalëshe që të kapërcejnë dhe të çmontojnë këtë rend të gjërave të paqëndrueshëm.

- [1] Dana Abed dhe Fatimah Kelleher (2022). *The Assault of Austerity: How Prevailing Economic Policy Choices are a Form of Gender-Based Violence*. <https://policy-practice.oxfam.org/resources/the-assault-of-austerity-how-prevailing-economic-policy-choices-are-a-form-of-g-621448/> [Vizituar më 13 Maj 2024].
- [2] Rachel Easter, [Amy Friedrich-Karnik](#) dhe [Megan L. Kavanaugh](#), (2024), *Any Restrictions on Reproductive Health Care Harm Reproductive Autonomy: Evidence from Four States*. <https://www.guttmacher.org/report/any-restrictions-reproductive-health-care-harm-reproductive-autonomy-evidence-four-states> [Vizituar më 13 Maj 2024].
- [3] <https://www.aljazeera.com/news/2024/5/12/un-chief-urges-immediate-ceasefire-in-gaza-as-35000-palestinians-killed> [Vizituar më 13 Maj 2024].
- [4] Centre for Feminist Foreign Policy (2024) *Strongmen and Violence: Interlinkages of anti-feminism and anti-democratic developments*. Centre for Feminist Foreign Policy, Berlin. <https://centreforfeministforeignpolicy.org/wordpress/wp-content/uploads/2024/02/CFFP-strongmen-and-violence.pdf> [Vizituar më 13 Maj 2024].
- [5] <https://www.voanews.com/a/internal-documents-show-the-world-health-organization-paid-sexual-abuse-victims-in-congo-250-each/7354013.html> [Vizituar më 13 Maj 2024].
- [6] Kerry Cullinan (2024) *Row over Reproductive Rights Group at WHO Executive Board 'Undermines' Secretariat and 'Science-Based' Approach*. [Vizituar më 13 Maj 2024].
- [7] Të tilla si: The [Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination Against Women \(CEDAW\)](#), traktati ndërkombëtar i miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara; The [Beijing Declaration and Platform for Action \(BpFA\)](#), rënë dakord gjatë Konferencës së 4-t Botërore për Gratë në vitin 1995; The [Maputo Protocol Advances African Women's Rights](#), miratuar nga Bashkimi Afrikan në vitin 2003 dhe hyrë në fuqi në vitin 2005.

**Credits:**

*We deeply appreciate Mikele Gajda for this thoughtful translation. We're truly grateful for your generosity and the genuine dedication you've shown in supporting this cause.*